



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 482 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

VENDIM Nr. 61, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturorë" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë "Kisha e Shën Mërisë Mamurras"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Dr. Luan Përzhita dhe MA. Brunilda Bregu, Universitë Bourgogne Franche-Comté, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë "Kisha e Shën Mërisë Mamurras"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Dr. Luan Përzhita dhe MA. Brunilda Bregu, Universitë Bourgogne Franche-Comté, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - a) Pastrimi i përgjithshëm i anës juglindore të pjesës së jashtme të kishës.
 - b) Gjermimi i kishës:
 - Sondazhi i parë i realizuar në verilindje të nefit qëndror do të vijojë në pjesën lindore të këtij nefi;
 - Gjermim arkeologjik nga absida lindore deri në hyrjen e parë nga lindja.
 - c) Rilevim topografik i mureve të identifikuara pas pastrimit të pjesës juglindore si dhe rilevimi për kishën, e cila ndodhet 2 km nga kisha e Shën Mërisë, me qëllim pasjen e një plani topografik të kësaj kishë të panjohur më parë.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTRI



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO